



**RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK “PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA
NË VITIN 2022 “**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK “PËR ZBATIMIN
E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E PERFORMANCËS
TË EVADUARA NË VITIN 2022,**

**PËR AUDITIMIN ME TEMË: “EFEKTIVITETI I MENAXHIMIT TË SISTEMIT TË
IDENTIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KAFSHËVE - RUDA”**

NË SUBJEKTET:

- 1. MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL, (MBZHR),**
- 2. AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE, (AKVMB),**
- 3. AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, (AKU), DHE**
- 4. INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË (ISUV),**

DHJETOR 2023

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje Ekzekutive	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
2. <i>Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh</i>	Error! Bookmark not defined.
3. <i>Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh</i>	Error! Bookmark not defined.
4. <i>Statusi i pranimit të rekomandimeve</i>	Error! Bookmark not defined.
II. Hyrja.....	Error! Bookmark not defined.
II.1. Objekti i auditimit.....	Error! Bookmark not defined.
II.2. Qëllimi i auditimit:.....	Error! Bookmark not defined.
II.3. Metodologjia e auditimit:	Error! Bookmark not defined.
II.4. Konkluzioni:	Error! Bookmark not defined.
II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:.....	Error! Bookmark not defined.
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	Error! Bookmark not defined.
IV. Konkluzione dhe Rekomandime.....	Error! Bookmark not defined.
A. Propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi.....	Error! Bookmark not defined.
B. Masa organizative	Error! Bookmark not defined.
C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike. ..	Error! Bookmark not defined.
Aneksi 1	32

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 655 prot, datë 17.07.2023 mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në vitin 2022”, ushtroi auditim në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe njësitë e varësisë:

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, (AKVMB),

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, (AKU), dhe

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV),

pjesë e Auditimit të Performancës me temë: “Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve - Ruda”.

Auditimi i kryer në vitin 2022, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2019 deri më datën 31.12.2021 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me shkresën përcjellëse nr. 99/13, datë 12.09.2022, të Kryetarit të KLSH-së, drejtuar subjekteve të sipër cituar, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2022, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandimeve që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajt Akt-Verifikimi Nr. 1, me nr. 4014/1, datë 04.08.2023.

Nga MBZHR është dërguar shkresa me nr. 4299, datë 03.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 99/19, datë 07.08.2023, me lëndë: “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna, shkresë e cila duhet të ishte dërguar pas 6- muajsh, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Në lidhje me akt verifikimin e mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së nuk janë paraqitur observacione nga subjektet në auditim.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna: Nga auditimi u konstatua se, MBZHR ka miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit duke e dërguar në KLSH me shkresë nr. 2077/9, datë 10.10.2022, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja j.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportim në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

Nga auditimi u konstatua se subjekti ka dërguar raportim në KLSH, jashtë afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve, konkretisht me shkresën nr. 4299, datë 03.08.2023, protokolluar në KLSH me nr. 99/19, datë 07.08.2023, me lëndë: “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. nr. 99/13, datë 12.09.2022, janë rekomanduar gjithsej:

Masa organizative 40 rekomandime

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, Mbi planin e masave, lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	5	5	-
2	Organizative	31	31	-
3	Masa për eliminimin e efekteve negative	4	4	-
	Gjithsej	40	40	-

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudhën 01.01.2022 deri 31.12.2022, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr. 67, datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 655 prot, datë 17.07.2023 mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në vitin 2022”. Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm me temë “Efektiviteti i menaxhimit të sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve - Ruda” me konkluzionet përkatëse i janë dërguar subjektit të audituar Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe njësisë të varësisë: Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, (AKVMB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, (AKU), dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), me shkresën e Kryetarit të KLSH-së, nr. 99/13, datë 12.09.2022.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. E.LL, përgjegjës grupi
2. V.G, anëtare
3. E.D, anëtar

Auditimi ka filluar më, 17.07.2023
Auditimi ka përfunduar më, 04.08.2023

II.1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të përcjella në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, (AKVMB), Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, (AKU) si dhe Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), me shkresën e Kryetarit të KLSH-së nr. 99/13, datë 12.09.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 të nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, (AKVMB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, (AKU) si dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, të përcjellë me shkresën 99/13, datë 12.09.2022, rezulton se nga 40 (dyzet) masa të rekomanduara gjithsej të cilat janë pranuar nga subjektet e audituara. Nga këto masa:

janë zbatuar 26 rekomandime ose 65 % e tyre,

janë pa zbatuar 4 rekomandime ose 10 % e tyre,

gjenden në proces zbatimi 10 rekomandime ose 25 % e tyre,

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	5	1		2	2
2	Masa organizative	31	23	1	7	0
3	Masa për eliminimin e efekteve negative	4	2			2
	Gjithsej	40	26	1	9	4

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	5	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	5	100%

	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	1	20%
2	Zbatuar pjesërisht	0	
3	Në proces zbatimi	2	40%
4	Pa zbatuar	2	40%

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	31	100
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	31	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	23	74,19
2	Zbatuar pjesërisht	1	3,23
3	Në proces zbatimi	7	22,58
4	Pa zbatuar	0	10

Nr.	Statusi i masave për eliminimin e efekteve negative	Në numër	Në %
1	Totali	4	100
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	4	100
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	2	50
2	Zbatuar pjesërisht	0	
3	Në proces zbatimi	0	
4	Pa zbatuar	2	50

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është rreth 65 %, për disa nga masat organizative të lëna (institucionet) nuk kanë mundur realizimin e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna dhe garantimin e një menaxhimi më të mirë të sigurisë ushqimore e shëndetit të njerëzve, nga institucionet përkatëse.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

Pyetja 1. A reflektojnë dhe a mbartin politikën, strategjitë dhe dokumentet e hartuara nga MBZHR, impaktin e duhur dhe zgjidhje racionale, efektive nga shërbimet veterinarë, për sistemin (RUDA)?

1.1 A është i plotë kuadri ligjor rregullator në fuqi dhe përfrimi me legjislacionin e BE-së?

Gjetje nga auditimi:

1. MBZHR përdor si bazë ligjore për menaxhimin e sistemit të informacionit veterinar RUDA, dy ligje, ligjin nr.8702, datë 01.12.2000 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale” i ndryshuar dhe ligjin nr.71/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të cilët kanë

mbivendosje kompetencash, për çështje që lidhen me mënyrën e monitorimit, ndarjen e përgjegjësiave, financimin e sistemit RUDA dhe financimin për shërbimet veterinarë, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, impaktojnë menaxhimin e sistemit.

2. Ligji nr.8702, datë 01.12.2000, de jure ekziston, por de facto nuk funksionon, pasi aktet nënligjore dhe aktet administrative të miratuara nga MBZHR si organi qendror dhe strukturat e saj të varësisë, të cilat kanë lidhje me shërbimin veterinar, i referohen vetëm ligjit nr.10465, datë 29.9.2011.

3. MBZHR nuk ka ende një rregullore të plotë mbi metodat e identifikimit dhe regjistrimit në lidhje me llojin e secilit kafshë, të parashikuar në modulet e sistemit RUDA (njëthundrake, dythundrake, shpendë, bletë etj.) të mbështetur vetëm në një bazë ligjore, por ka disa rregullore të fragmentuara, të mbështetura në baza ligjore jo të njëjta.

4. MBZHR nuk ka hartuar plan veprimi mbi Strategjinë Nder sektoriale e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (SNZHRB) 2014-2020, e cila do të shërbente për të përcaktuar në mënyrë qartësisht të identifikueshme strukturat përgjegjëse, afatet, kostot, produktet dhe mënyrën e monitorimit të strategjisë si dhe MBZHR nuk ka kërkuar rinovime të Strategjisë, që reflektojnë fokusin e politikë bërjes në diversifikimin e aktiviteteve e shërbimit veterinar, në mbështetje të ligjeve të ndryshuara. Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa duke ngritur një grup pune me të gjithë aktorët e përfshirë në shërbimin veterinar, për të sintetizuar në mënyrë të qartë dhe të plotë një ligj të vetëm për shërbimin veterinar në përshtatshmëri dhe me Direktivat e BE-së, si dhe duke shfuqizuar ligjin nr.8702, datë 01.12.2000 “Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale” i ndryshuar, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të shërbimit veterinar.

Brenda datës 31.12.2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga sa më sipër deri tani grupi i punës i ngritur sipas Urdhrit nr. 449, datë 11.10.2022, ka përgatitur Draftin e Ligjit “Mbi shëndetin e kafshëve”, tabelat e përputhshmërisë sipas neneve përkatëse si dhe RIA-n.(Vlerësimi i impaktit të risqeve).

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për miratimin e një rregulloreje të plotë dhe jo më të fragmentuar, mbi metodat e identifikimit dhe regjistrimit në lidhje me llojin e secilit kafshë, të parashikuar në modulet e sistemit RUDA (njëthundrake, dythundrake, shpendë, bletë etj.) të mbështetur mbi një bazë ligjore të unifikuar dhe në përshtatshmëri me Direktivat BE-së.

Brenda datës 31.12.2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga verifikimi i dokumentacionit, grupit të auditimit iu paraqitën Draft Rregullorja dhe materialet ndihmëse të punuara nga MBZHR. Pra rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore ka përgatitur draft rregulloren e cila është në proces përshtatjeje.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për miratimin e Strategjisë së plotë të Sigurisë Ushqimore si dhe Plane Veprimi, ku të jetë përfshirë mirëqenia e kafshëve, e cila impakton jo vetëm sistemin e informacionit veterinar RUDA por edhe synon të ofrojë garancinë në sigurinë ushqimore brenda dhe jashtë vendit.

Brenda datës 30.06.2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në bazë të rekomandimit të lënë nga KLSH-ja kjo strategji është miratuar me urdhrin e Ministrit Nr.366, datë 16.6.2023 “Për Miratimin e Strategjisë të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”, dhe është botuar në fletoren zyrtare.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

1.2 A i ka shërbyer ky kuadër efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit?

Gjetje nga auditimi:

5. Kuadri aktual ligjor nuk ka vepruar në funksion të efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit veterinar, e për pasojë laboratorët për mirëqenien e kafshëve pranë AKU nuk kryejnë analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve të ndryshëm në kafshë të gjalla. Këto analiza realizohen nga ISUV. Kjo situatë është shkaktuar, si rrjedhojë e mos planifikimit të buxhetit për nisjen e procesit të akreditimit të laboratorëve, mos sigurimit të infrastrukturës së rrjetit laboratorik me pajisje si dhe mosparashikimi i kompetencës ligjore për marrjen e kampioneve (mostrave) nga inspektorët e AKU-së.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

4. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të hartojë dhe miratojë akte administrative ligjore, për kalimin pranë ISUV, të kapaciteteve të burimeve njerëzore të stafit të laboratorëve të shëndetit të kafshëve dhe të sigurimit të vazhdueshëm të burimeve financiare, me qëllim rritjen e efektivitetit të laboratorëve për shërbimin veterinar.

Brenda datës 31.06.2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga MBZHR dhe ISUV nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

6. Lëvizja e kafshëve të importit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) në destinacion fermë, është objekt i dy kontrolleve nga dy autoritete AKU dhe AKVMB, të cilët nuk janë të unifikuar mbi këtë proces, për shkak të boshllëkut dhe mbivendosjes ligjore të funksionimit të institucioneve.

7. Inspektorët e AKU-së, në pikat e inspektimit kufitar (PIK), nuk kanë akses në sistemin RUDA, pasi sistemin e popullojnë vetëm struktura e shërbimit veterinar rajonal (AKVMB), në momentin kur ata shkojnë në destinacionin e pretenduar ku do të shkojë kafsha e gjallë. Hedhja e të dhënave individuale të kafshëve në PIK, si dhe ngarkimi i dokumentacionit është mjaft i rëndësishëm, pasi identifikimi i hyrjes së çdo kafshe në kohë në territorin e Shqipërisë, duke pasqyruar historikun e sëmundjeve nëse kanë pasur, me mjekimet e ndryshme që mund të kenë marrë, jep besueshmëri në sistemet e kontrollit në paralajmërim, përballimin e sëmundjeve si dhe sjell siguri të lartë ushqimore për konsumatorët shqiptarë dhe më gjerë.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të hartojë dhe miratojë akte administrative ligjore, të hartojë politika për menaxhimin e riskut, në lidhje mbi kontrollin e lëvizjes së kafshëve të gjalla në Pikat e Inspektimit Kufitar nga struktura e shërbimit rajonal/AKVMB, më qëllim kryerjen me efektivitet të të gjithë veprimtarisë së shërbimeve veterinarë rajonale, të cilat impaktojnë menaxhimin e sistemit të informacionit RUDA.

Brenda vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga MBZHR, nuk është ndërmarrë ende asnjë masë për nxjerrjen e akteve administrative për hartimin e politikave të menaxhimit të riskut, në lidhje mbi kontrollin e lëvizjes së kafshëve të gjalla në Pikat e Inspektimit Kufitar nga struktura e shërbimit rajonal/AKVMB

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

2. A kanë shërbyer strukturat, infrastruktura dhe burimet financiare, menaxhimit efektiv të sistemit RUDA? (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 35-75, Raportit të Auditimit).

2.1 A kanë qenë efektive, financimi operacional, burimet fizike dhe investimet kapitale, niveli i duhur i personelit, ndërveprimi dhe koordinimi i subjekteve të përfshirë, brenda dhe jashtë AKVMB për periudhën në auditim?

Gjetje nga auditimi:

8. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe në Sektorin e Veterinarisë, Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve në varësi të DPPSUV, nuk rezultoi të ketë gjurmë të kryerjes së analizave operacionale për menaxhimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit RUDA, nuk janë hartuar plane për trajnimin e specialistëve veterinarë në fushën e shëndetit dhe të kafshëve për periudhën 2019-2020. Strukturat e mësipërme nuk kanë të dokumentuar asnjë raportim mujor apo periodik për punën e kryer në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes së kafshëve.

Rekomandime:

6. Drejtorja e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për kryerjen e raportimeve dhe analizave periodike të punës së kryer për të realizuar një komunikim efektiv, të matshëm dhe rritur performancën e punës së kryer.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorja e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, (Sektori I&R dhe Sektori i shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve) të marrë masat që në hartimin e planeve vjetore për çdo aktivitet të synojë krijimin e një sistemi sa më të sigurt në sigurinë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit nga “ferma në tavolinë”, në përputhje me standardet e BE.

Në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së për rekomandimet (6-7): Nga verifikimi i shkresave dhe e maileve të sektorëve përkatës objekt auditimi janë kryer raportimet dhe analizat periodike të punës së kryer nga drejtorja e Sigurisë Ushqimore në MBZHR.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër këto rekomandime konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara.

Gjetje nga auditimi:

9. Si rezultat i: (i) mungesës së vazhdueshme të monitorimit nga strukturat veterinare në rrethe të zbatimit të detyrimeve kontraktuale me klinikat veterinare private me të cilat menaxhimi kryhej nëpërmjet procedurave të prokurimit publik; (ii) mos vendosjes së penalteteve nga autoriteti kompetent në rastet e shkeljes së këtyre detyrimeve sipas kontratës tip /Vonesa në kryerjen e shërbimit; (iii) mos vendosjes së indikatorëve për matjen e performancës së punës së veterinerëve nga ish - Drejtoria e De rregullimit, lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MBZHR për 2019 (aktualisht Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore), aktiviteti i klinikave private në drejtim të Identifikimit, regjistrimit dhe gjurmueshmërisë së kafshëve, rezultoi jo efektiv si dhe shuma prej 289,701 mijë lekë, nga buxheti i shtetit, për periudhën 2016-2019 është përdorur pa efektivitet.

Rekomandime:

8. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të bashkërendojë punën dhe të rrisë kontrollin në Drejtorinë Rajonale Veterinare dhe Mbrojtjes së Bimëve të cilat kanë përgjegjësinë kryesore në “popullimin” apo “de popullimin” e sistemit RUDA.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të analizojë efektivitetin e burimeve njerëzore të përbërë prej 231 Veterinerë Zyrtarë Kontrolli dhe 303 Veterinerë Zyrtarë Shërbimi, nëpërmjet zbrërthimit të politikave në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, hartimit të planeve konkrete të punës për kryerjen e kontrolleve zyrtare në ofrimin e shërbimeve veterinare, për të rritur efektivitetin e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm në zinxhirin e sigurisë ushqimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: AKVMB në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, ka dërguar shkresë me nr.505/3, dt. 03.10.2022. Nisur nga përgjigjja e subjektit në lidhje me rekomandimet 8-9, rezultoi që nga AKVMB/Drejtoria e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, janë kryer sipas planeve të sipër cituara kontrolle në 4- Drejtorinë rajonale të veterinarisë dhe janë mbajtur relacionet përkatëse me rekomandimet e dhëna duke dokumentuar çdo veprim.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër rekomandimet 8-9, konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara.

Gjetje nga auditimi:

10. Mungesa e gjurmës së auditimit nga MBZHR dhe AKVMB, për një sërë aktivitetesh që lidhen me monitorimin dhe numrin e subjekteve të kontrolluara, arsyet e riskut për inicimin e kontrolleve të subjekteve, planit vjetor të kontrolleve i cili duhet të jetë i miratuar në fillim të vitit me objektiva të qarta dhe të matshme e afate kohore të mirë përcaktuara ka sjellë performancë të dobët të drejtorive veterinare në rajone edhe pse është shtuar ndjeshëm numri i punonjësve veterinerë për vitin 2021.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

10. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në bashkëpunim me Drejtorinë e Veterinarisë të dokumentojnë çdo praktikë pune duke hartuar planet

e punës afatmesme dhe afatgjata të DP dhe të Drejtorive rajonale me indikatorë të qartë e të matshëm në veprimtarinë e punës së veterinerëve te kontrollit dhe atyre të shërbimit, dhe të vendosin afate konkrete në realizimin e detyrave funksionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga Drejtoria e Veterinarisë në DPAKVMB u hartuan plane mujore afatgjatë dhe plane mujore.

Për vitin 2023 Drejtoria e Veterinarisë hartoi një plan afat gjatë vjetor me monitorime në Drejtoritë Rajonale sipas muajve, Plani Pune Për çdo muaj ne Vitin 2023 afatmesëm.

Plani i Punës për monitorimin e subjekteve të shpendëve dhe survejancën e tyre nr. 1089 prot. datë 14.09.2022.

Planet mujore të Drejtorive Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.(bashkëlidhur planet mujore dhe plani vjetor i AKVMB-së.)

Nisur nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi që AKVMB ka hartuar dhe ndjekur zbatimin e planeve mujorë dhe vjetorë sipas Drejtorive rajonale duke identifikuar problematikat e dala dhe ecurinë e aktivitetit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

11. Nga auditimi i analizës vjetore të Drejtorisë së veterinarisë në AKVMB u konstatuan mangësi në plotësimin e detyrave funksionale të kësaj drejtorie që konsistojnë në sa vijon:

- Drejtori i veterinarisë raportoi vetëm detyrat e veterinerit por jo të Drejtorisë së veterinarisë në Drejtorinë e Përgjithshme.

- Në Programet Kombëtare Profilaktike të zbatuara gjatë vitit, të ndarë sipas drejtorive rajonale mungonte analiza e DP mbi zhvillimin dhe zbatimin e një plani të komunikimit me fermerët për të nxitur të kuptuarit e rëndësisë së plasjes së kafshëve dhe shëndetit të njeriut, si dhe për të promovuar bashkëpunimin aktiv të fermerëve në aplikimin e masave të kontrollit.

- Mungon program i takimeve në nivel lokal, bazuar në “zonat e nxehta” të konfirmuara në vite, për të rritur ndërgjegjësimin e masave për parandalimin e sëmundjes mes fermerëve, familjeve të tyre dhe profesionistëve të tjerë (punëtorët e thertoreve, kasapëve, industrisë lëkurë, etj.).

- Nuk janë kryer trajnime rifreskuese për veterinerët zyrtarë për të kryer hetime mbi shpërthimin e sëmundjeve të ndryshme.

- Në lidhje me raportimin e procesit të vaksinimit si një nga proceset kryesore në gjurmueshmërinë e sëmundjeve të kafshëve blegtorale që ka ndikim të drejtpërdrejt në sigurinë ushqimore të konsumatorit, për vitin 2021, ky proces ka rezultuar i mangët pasi plani i vaksinave është realizuar në masën 87,7% të asaj që është planifikuar nga AKVMB-të rajonale.

- Në numrin e fermave të testuara sipas fazave, janë konstatuar mungesa të analizës nga DV në AKVMB, të këtyre faktorëve:

Mungon koha e konfirmimit të sëmundjeve.

Mungon informacioni për eliminimin e kafshëve nga data e konfirmimit pozitiv.

Mungojnë të dhëna mbi procesin e përditësimit të regjistrimit të fermave nga inventarizimi gjatë zbatimit të këtij programi.

Mungojnë të dhëna në lidhje me informimin e AKU-së për rastet pozitive me Brucelozë.

Informacioni mbi numrin total të kafshëve mungon.

Informacion mbi mbajtjen e dokumentacionit në fermë.

Informacion mbi raportet mujore për zbatimin e Planit të Kontrollit të Brucelozës në Gjerdh.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

11. Drejtoria e Veterinarisë të koordinojnë punën me drejtoritë veterinarë në rajone në zbatimin e procesit të regjistrimit të fermave blegtorale, identifikimit të kafshëve dhe lëvizjes së kafshëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Drejtoria e Veterinarisë, të mbajë dhe përditësojë sistemin RUDA, duke u dhënë të drejtën për akses dhe përdorim në bazë të aktivitetit në sistem, të gjithë veterinerëve të AKVMB-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Drejtoria e Veterinarisë të autorizojë dhe ushtrojë kontrole për mënyrën e zbatimit të detyrave kontrolluese dhe të shërbimit nga drejtoritë rajonale, me grupe të kontrollit me përbërje sipas urdhrit konkret, për të kryer verifikimin e veprimtarisë parapërgatitore, kontrollit të ushtruar në subjekte dhe gjetjeve dhe vendimmarrjeve në subjektet e kontrolluara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Për rekomandimet 11-12-13, nga AKVMB janë kryer:

Plan Pune Për Lëvizje në datën 31-2 Qershor 2022.

Autorizimi Nr.654/4 prot. Datë 1.06.2022 ‘Për kontrollin e pasaportave të matrikulimit, certifikatat e lëvizjeve, fermat e reja dhe subjektet e licencuara në DRVMB Elbasan.

Autorizimi Nr.654 prot. Datë 31.05.2022 ‘Për kontrollin e pasaportave të matrikulimit, certifikatat e lëvizjeve, fermat e reja dhe subjektet e licencuara dhe monitorimi i inspektimeve të kryera në fermë në DRVMB Elbasan.

Procesverbal nr. 654/5 datë 03.06.2022.

Autorizimi Nr.883/1 prot. Datë 25.07.2022 Për verifikimin e matrikujve dhe certifikatat e shpërndara tek veterinerët e shërbimit dhe mbajtja e dokumentacionit shoqërues si dhe dalja nga magazina e matrikujve dhe certifikatat e lëvizjes, verifikim nga periudha janar 2022 e në vazhdim dhe rakordim me sistemin Ruda, kontroll të kartelave të plotësuara të matrikujve dhe certifikatave të lëshuara nga çdo veteriner shërbimi dhe hedhja e tyre në sistemin Ruda në DRVMB Vlorë, qarku Vlorë, më datë 18.10.2022 dhe datë 19.10.2022.

Procesverbal nr. 883/4 datë 28.07.2022.

Plan Pune Për Lëvizje në datën 17-18 Gusht 2022.

Autorizimi nr.983/1 prot. Datë 17.08.2022 ‘Për kontrollin e matrikulimit, fermat e reja dhe certifikatat e lëvizjes në DRVMB Elbasan.

Procesverbal nr. 983/5 datë 22.08.2022.

Autorizimi Nr.1300 prot. Datë 14.11.2022 ‘Për kontrollin e subjekteve importuese dhe subjektet e rritjes së shpendëve në DRVMB Tiranë.

Procesverbal nr. 1300/1 datë 09.11.2022.

Urdhër nr.150 prot. Datë 15.10.2022 për ‘Ngritjen e grupit të kontrollit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve dhe fermave blegtorale’.

Autorizimi nr.1383 prot. Datë 13.12.2022 për zbatimin e urdhrit Nr.150 prot. Datë 15.10.2022.

Procesverbal nr. 1383/4 datë 13.12.2022.

Plan Pune Për Lëvizje në datën 18-19 Tetor 2022 Nr. 1219 prot. datë 17.10.2022.

Autorizimi Nr.1219/1 prot. Datë 18.10.2022 ‘Për verifikimin e matrikujve dhe certifikatat e shpërndara tek veterinerët e shërbimit dhe mbajtja e dokumentacionit shoqërues si dhe dalja nga

magazina e matrikujve dhe certifikatat e lëvizjes, verifikim nga periudha janar 2022 e në vazhdim dhe rakordim me sistemin Ruda, kontroll të kartelave të plotësuara të matrikujve dhe certifikatave të lëshuara nga çdo veteriner shërbimi dhe hedhja e tyre në sistemin Ruda në DRVMB Vlorë, qarku Vlorë, më datë 18.10.2022 dhe datë 19.10.2022.

Procesverbal nr. 1219/4 datë 20.12.2022.

Plan Pune Për Lëvizje në DRVMB Vlorë në datën 01-02-03 Mars 2023 Nr. 188 prot.

Autorizimi Nr.188/1 prot. Datë 28.02.2023 ‘Për kryerjen e kontrolleve mbi dokumentacionin e censusit blegtoral dhe plotësimin e regjistrit të fermës në sistemin Ruda, mbi realizimin e detyrave nga veterinerët e mesëm të shërbimit si dhe marrjen e bazës materiale dhe shërbimet e kryera në zonën që ato mbulojnë, në DRVMB Vlorë, qarku Vlorë, qarku Gjirokastrë, qarku Fier.

Procesverbal nr. 188/6 datë 06.03.2023.

Procesverbal nr. 188/7 datë 06.03.2023.

Procesverbal nr. 188/8 datë 06.03.2023.

Shkresë nr.188/3 datë 09.03.2023 me lëndë: “Përcjellim rekomandimet’ për Drejtorinë Rajonale Vlorë”.

Nisur nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi që AKVMB ka hartuar dhe ndjekur analizat vjetore dhe ka monitoruar sistematikisht aktivitetin e 4-Drejtorive Rajonale.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër Rekomandimet 11-12-13, konsiderohen të pranuar dhe të zbatuara.

Gjetje nga auditimi:

12. Nga auditimi rezultoi se dy sektorë me rëndësi të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve krijuar në 2021, Sektori i Raportimit dhe Koordinimit, dhe Sektori i Auditit të Brendshëm, kanë qenë pothuaj jo ekzistent, i pari për arsye të moskryerjes së detyrave të tij funksionale në bashkëpunimin me strukturat e tjera të AKVMB-së për koordinimin, zbatimin e planeve kombëtare të kontrolleve zyrtare dhe veprimtarive të tjera të parashikuara në planin e punës në fushën e veterinarisë; dhe i dyti, Sektori i Auditit të Brendshëm ka qenë dhe vazhdon dhe të jetë me mungesë të burimeve njerëzore (prej 3 audituesish), duke mos luajtur rolin e tij në ngritjen dhe administrimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, hartimit të planeve të verifikimit dhe auditimit të DRVMB-ve për të përcaktuar indikatorët e performancës dhe zbatimin ose jo të detyrave të lëna. Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

14. Sektori i Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në bashkëpunim me DAP, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin me punonjës të pajisur me certifikatë auditimi në sektorin e Auditit të brendshëm i cili me punën e tij do të ndihmojë Autoritetin për të arritur objektivat e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menjeherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Sektori i Auditimit të Brendshëm ka qenë vakant që nga krijimi i AKVMB, edhe pas shpalljeve nga DAP ka rezultuar pa kandidatë fitues. Pozicionet për Sektorin e Auditimit të Brendshëm janë dërguar në DAP me anë të shkresës nr. 1100/1 prot., datë 19.9.2022 “Kërkesë për shpallje vende vakante pjesë e shërbimit civil” për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe nëpërmjet shkresës nr. 458 prot., datë 15.5.2023. Nisur nga sa më sipër AKVMB ka zbatuar rekomandimin nëpërmjet shkresave të dërguara në DAP, por

aktualisht Sektori i Auditit vazhdon ende i paplotësuar, edhe pas shpalljeve pasi ka rezultuar pa kandidatë fitues.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

15. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të monitorojë punën dhe funksionet e Sektorit të Raportimit dhe Koordinimit, për zbatimin e planeve kombëtare të kontrolleve zyrtare dhe veprimtarive të tjera të parashikuara në fushën e veterinarisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

a. Sektori i Raportim Koordinimit në zbatim të planeve të punës së Drejtorive Rajonale të Veterinarëve dhe Mbrojtjes së Bimëve, pas përpunimit të të dhënave të raportuara, përgatit raporte javore dhe mujore për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në rrugë elektronike, nga personi i autorizuar brenda këtij sektori (danjel.sovjani@akvmb.gov.al) Bashkëlidhur dokumentacioni i printuar nga kjo adresë e-maili nga data 01.08.2022-01.08.2023.

b. Sektori i Raportim Koordinimit me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1110/4prot., datë 27.04.2022 dhe nr.355/2prot., date 06.04.2023 ka bërë shpërndarjen e vaksinës së Plasjes dhe Tuberkulinës sipas planit kombëtar të shpërndarjes në 4-Drejtorit Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

c. Gjithashtu, Sektori i Raportim Koordinimit me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe në përbushje të detyrave funksionale ka qenë organizatore dhe monitorues të aktiviteteve si "Ditët e Bujqësisë 2023", "Dita Botërore e Veterinarisë si dhe ka marr pjesë në kontrolle dhe inspektime të ndryshme sipas tematikës së caktuar. Bashkëlidhur dokumentacioni.

Gjithashtu, ky Sektor, ka ndjekur, trajtuar deri në përgjigje shteruese dhe zgjidhur, rastet e bëra prezent në adresën zyrtare të AKVMB-së, infoAkvmb.gov.al, dhe në numrin e gjelbër 0800 33 66. Bashkëlidhur do të gjeni rastet.

Për rekomandimin e mësipërm, është kryer nga AKVMB:

a. Sektori i Raportim Koordinimit në zbatim të planeve të punës së Drejtorive Rajonale të Veterinarëve dhe Mbrojtjes së Bimëve, pas përpunimit të të dhënave të raportuara, përgatit raporte javore dhe mujore për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në rrugë elektronike, nga personi i autorizuar brenda këtij sektori. Bashkëlidhur dokumentacioni i printuar nga kjo adresë e-maili nga data 01.08.2022-01.08.2023.

b. Sektori i Raportim Koordinimit me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 1110/4prot., datë 27.04.2022 dhe nr.355/2prot., date 06.04.2023 ka bërë shpërndarjen e vaksinës së Plasjes dhe Tuberkulinës sipas planit kombëtar të shpërndarjes në 4-Drejtorit Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

c. Gjithashtu, Sektori i Raportim Koordinimit me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe në përbushje të detyrave funksionale ka qenë organizatore dhe monitorues të aktiviteteve si "Ditët e Bujqësisë 2023", "Dita Botërore e Veterinarisë si dhe ka marr pjesë në kontrolle dhe inspektime të ndryshme sipas tematikës së caktuar. Bashkëlidhur dokumentacioni.

Gjithashtu, ky Sektor, ka ndjekur, trajtuar deri në përgjigje shteruese dhe zgjidhur, rastet e bëra prezent në adresën zyrtare të AKVMB-së, infoAkvmb.gov.al, dhe në numrin e gjelbër 0800 33 66. Bashkëlidhur do të gjeni rastet.

Nisur nga sa më sipër AKVMB ka zbatuar rekomandimin nëpërmjet shkresave të dërguara dhe e-maileve bashkëlidhur, nga ku rezulton që ky sektor është tashmë eficient.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

13. Deri në muajin maj të vitit 2022, rezultoi një numër i madh vendesh vakant punonjësish edhe me ri-organizimin e DRVMB-ve në shtator të 2020; konkretisht 101 punonjës të munguar në sistemin veterinar nga 611 të planifikuar, çka ka sjellë mosrealizim të detyrave funksionale dhe performancë të ulët të AKBMB-së, për vitin 2021 e në vazhdim. Mos plotësimi i vendeve vakant, është përgjegjësi dhe mungesë e theksuar vëmendjeje e Drejtuesve Rajonalë, Drejtorit të Përgjithshëm të AKVMB, e cila rrezikon përmbushjen e detyrave funksionale të DRVMB-ve.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

16. Sektori i Burimeve Njerëzore në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në bashkëpunim me Drejtorët Rajonalë dhe DAP të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e vendeve vakante sipas kriteve të punës.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Sa i përket plotësimit të vendeve vakante për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve janë bërë përpjekje të vazhdueshme për plotësimin e tyre pas komunikimeve të herë pas herë me Departamentin e Administratës Publike nëpërmjet sistemit HRMIS, komunikimeve shkresore (bashkëlidhur) si dhe nëpërmjet e-mailit.

Me DAP është komunikuar nëpërmjet shkresës nr.1100 prot, datë 15.9.2022 “Kërkesë për shpallje vende vakante pjesë e shërbimit civil” për Drejtoritë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Shkodër; nëpërmjet shkresës nr. 1100/1 prot., datë 19.9.2022 “Kërkesë për shpallje vende vakante pjesë e shërbimit civil” për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; nëpërmjet shkresës nr. 1 prot., datë 04.01.2023 “Kërkesë për shpallje vende vakante pjesë e shërbimit civil” për Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; dhe nëpërmjet shkresës nr. 458 prot., datë 15.5.2023 “Kërkesë për shpallje vende vakante pjesë e shërbimit civil” me anë të së cilës rikujtojmë nevojën e menjëhershme që ka institucioni për publikimin e vendeve në faqen zyrtare të DAP. Për disa pozicione që janë hapur nga DAP konkursi ka qenë rezultativ për disa të tjera jo, dhe jemi akoma në pritje për shpalljen e pozicioneve të tjera të dërguara në DAP. Aktualisht AKVMB ka 13 vakanca, ndërsa drejtoritë rajonale kanë 101 vakanca total.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se janë rekrutuar shumë pak punonjës ose pothuajse fare punonjës të rinj me statusin e nëpunësit civil.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Gjetje nga auditimi:

14. Nga AKVMB, shpenzimet për investime në PBA fillestare të vitit 2021 ishin planifikuar në vlerën prej 174,660 mijë lekë, por nga MBZHR është miratuar vlera prej 94,949 mijë lekë, e cila përsëri ka pësuar ndryshime të paargumentuara dhe të pajustificuara gjatë vitit 2021, duke arritur në vlerën prej 17,309 mijë lekë planifikim, pra qartazi kemi zvogëlim të konsiderueshëm për shpenzime në infrastrukturë me vlerë prej 77,640 mijë lekë, edhe pse kemi një ristrukturim të organikës me një shtim të konsiderueshëm të numrit të veterinerëve nuk është pasqyruar detajim i saktë i shpenzimeve buxhetore në drejtim të investimeve, konkretisht për ndërtimin e godinës së re për Drejtorinë e Përgjithshme /AKVMB.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

17. MBZHR/Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa në rishikimin e buxheteve të AKVMB, duke analizuar me kujdes kërkesat sipas relacioneve përkatës, me qëllim prioritetin e fondeve për investime në DRVMB-të rajonale, për të rritur performancën e punës së veterinerëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi Zbatues në AKVMB të marrin masa që në të ardhmen të planifikojnë buxhete për vitin në përputhje me nevojat konkrete dhe më imediate të Institucionit duke i shoqëruar ato me relacione të mirë argumentuara bazuar edhe në nevojat e DRVMB-ve dhe të sigurojnë zbatimin e buxhetit të miratuar nga MBZHR me efektivitet dhe eficiencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së për rekomandimet(17-18):

Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi Zbatues në AKVMB kane planifikuar buxhetet në përputhje me nevojat konkrete dhe me imediate të institucionit (Drejtorisë së Përgjithshme të AKVMB dhe 4 Drejtorive Rajonale) duke i shoqëruar me relacion të mirë argumentuar.

Me relacionin nr. 910/4 Prot, date 12.08.2022 kemi përcjellë në MBZHR kërkesat për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023-2025 faza II për AKVMB (Dr. Përgjithshme dhe 4 Drejtoritë Rajonale) ku kemi mirë argumentuar secilin zë buxhetor të nevojshëm për realizimin e detyrave dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit. (bashkëlidhur).

Me relacionin nr. 267/5 Prot, date 06.04.2023 kemi përcjellë në MBZHR kërkesat për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026 për AKVMB (Dr. Përgjithshme dhe 4 Drejtoritë Rajonale) ku kemi mirë argumentuar secilin zë buxhetor të nevojshëm për realizimin e detyrave dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit. (bashkëlidhur).

Kemi siguruar përdorimin e buxhetit vjetor të miratuar nga MBZHR me eficiencë dhe efektivitet e cila pasqyrohet në evidencat e fund vitit ku për vitin 2022 kemi pasur 99% realizim buxheti.

Me shkresën nr. 84 prot, date 31.01.2023 kemi përcjellë në MBZHR informacionin mbi realizimin e fondeve buxhetore për vitin 2022 për Drejtorinë e Përgjithshme dhe 4 Drejtoritë Rajonale (bashkëlidhur).

Nga verifikimi i PBA-ve të AKVMB 2023-2025 drejtuar MBZHR, janë kryer kërkesat e argumentuara për rritje të buxhetit të shpenzimeve por rezultoi që nuk janë marrë në konsideratë duke u mbajtur në të njëjtin nivel shpenzimesh.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Gjetje nga auditimi:

15. Nga auditimi u konstatua që buxheti i alokuar sipas programit “Siguria Ushqimore e Mbrojtjes së Konsumatorit” për shërbimet veterinarë zë rreth 5,2 % të buxhetit të MBZHR-së, ose 1,7 milion lekë për një periudhë 3- vjeçare 2019-2021, kundrejt 32,8 milion lekë të buxhetit total të MBZHR, duke mos i dhënë prioritet këtij shërbimi kaq të rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë ushqimore dhe mbështetjen e fermerëve për motivimin dhe nxitjen në punën e tyre.

E njëjta situatë paraqitet edhe me peshën e buxhetit të programit “Siguria Ushqimore e Mbrojtjes së Konsumatorit” ndaj buxhetit të MBZHR-së, ku vihet re qartë që ka një prirje në rënie, 19% në vitin 2019, 14% në vitin 2020 dhe 12% në vitin 2021, e cila shkon në kah të kundërt me rritjen e buxhetit të MBZHR-së.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

19. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të analizojnë nevojën për fonde në shërbimet veterinarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nisur nga PBA 2022-2025, MBZHR ka rritur peshën specifike që shërbimet veterinarë zënë në Buxhetin total të saj dhe konkretisht për vitin 2022 e shprehur në shifra është 1,721 mln lekë kundrejt 13,600 mln (totali) dhe për vitin 2023/4- mujor nga raporti i monitorimit është rritur në 15,2 % ndaj totalit ose e thënë ndryshe 2,160 mln lekë ndaj 14,255 mln lekë. Nga verifikimi i PBA –ve dhe raporteve të monitorimit MBZHR ka rritur shpenzimet buxhetore për programin “Siguria Ushqimore e Mbrojtjes së Konsumatorit”, shërbimet veterinarë.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

16. Nga auditimi u konstatua alokim i fondeve të konsiderueshme nga MBZHR për blerjen e artikullit (matrikuj), ndonëse pranë Drejtorive rajonale veterinarë, ka numër të lartë gjendje të matrikujve, (konkretisht 2,750,000 matrikuj në të gjithë territorin e vendit deri në maj të 2022), pasojë kjo e mos rakordimit në kohë të Drejtorive Rajonale të shërbimit veterinar me AKVMB dhe me DPPSU në MBZHR, nga rënia e numrit të krerëve në vitin pasardhës, nga mos realizimi i procesit të matrikulimit nga fermerët si dhe mos informimi dhe ndërgjegjësimi i tyre në kohë.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

20. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve , të bashkërendojnë në mënyrë të vazhdueshme të dhënat e identifikimit të kafshëve në sistemin RUDA dhe të rakordojnë në kohë reale mbi gjendjen e matrikujve me Drejtoritë rajonale të veterinarisë në rajone për të kryer një planifikim sa më të saktë të shpenzimeve që do të planifikohen në vitin pasardhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në zbatim të kësaj pike Drejtoria e Veterinarisë në DPAKVMB ka kërkuar raportim mujor mbi hyrjen e matrikujve, daljen dhe gjendjen aktuale. Afati për dërgimin e informacionit është caktuar në datën 5 të çdo muaji dhe informacioni vjen në rrugë elektronike sipas formatit që do e gjeni bashkëlidhur.

Për nevojat e matrikujve sipas Drejtorive Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve u dërgua shkresa nr. 1427 prot. datë 23.12.2022 me lëndë: Dërgim informacioni mbi planifikimin e matrikujve 2023, sipas formatit të kërkuar nga MBZHR.

Për rakordim me MBZHR mbi gjendjen e matrikujve u dërgua shkresa nr.150 prot. datë 15.02.2023 me lëndë: “Dërgim informacioni mbi gjendjen e matrikujve deri në datën 31.01.2023”. Gjithashtu në çdo raportim mujor dërgohet dhe informacioni mbi matrikujt e vendosur nga drejtoritë rajonale çdo muaj me format raportimi sipas shkresës nr. 120 prot. datë 13.02.2023 dhe shkresa nr. 243 prot. datë 09.03.2023.

Nga verifikimi i shkresave të sipër cituara rezultoi se për matrikujt e remontit është bërë një ri shpërndarje e tyre nga rrethet me gjendje më të madhe mbi nevojat e vitit 2023 në rrethet me mungesë matrikujsh. Pra MBZHR dhe AKVMB kanë rezultuar të kenë marra masa efektive në menaxhimin e matrikujve për mbarëshitim.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

17. Nga auditimi u konstatua se, për muajin maj dhe qershor të vitit 2021, në mbarim të kontratës nr.2387 datë 07.05.2019 për mirëmbajtjen e sistemit “RUDA”, nga buxheti i MBZHR, janë shpenzuar 0 lekë, çka tregon që sistemi nuk është mirëmbajtur nga ana teknike, duke treguar mungesë vëmendje ndaj këtij sistemi nga strukturat e MBZHR, Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimi Financiar, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

21. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të monitorojë në mënyrë sistematike, funksionimin e sistemit I&R, në mirëmbajtjen e moduleve, hedhjen e të dhënave, ruajtjen e historikut, për dhënien e besueshmërisë në marrjen e informacionit të nevojshëm që ky sistem përmban.

Menjëherë dhe në vijimësi

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: MBZHR shprehet se: Mirëmbajtja e sistemeve elektronike bëhet nga Akshi dhe për vitin 2022 dhe 2023 në nuk kanë paguar mirëmbajtje për sistemin Ruda pra nuk kemi planifikuar buxhet, kjo sipas:

Sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar” pika 24, ku citohet se: Fondet buxhetore për shërbimet sipas shkronjës “i”, të pikës 6, të këtij vendimi, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, do të parashikohen në buxhetin vjetor të AKSHI-t. Për të gjitha institucionet jo buxhetore, AKSHI do t’i ofrojë shërbimet kundrejt tarifave. Efektet financiare të kësaj pike fillojnë më 1 janar 2019.

Si dhe Udhezimit nr 4 dt 27.02.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023" pika 9 citohet se:

Në zbatim të VKM nr. 673 date 22.11.2017 “Për- riorganizimin e Akshit”- AKSHI është institucioni i vetëm përgjegjës për kryerjen e procedurave të prokurimit, tenderimit dhe lidhjes së kontratës për të gjitha sistemet e Teknologjisë së Informacionit (TI). Për këtë qëllim, procedure që do të ndiqet është si vijon:

a. Lidhja e të gjitha kontratave për blerjen e mallrave dhe shërbimet për mirëmbajtjen e sistemeve TI (shpenzime kapitale dhe korente), kryhet nga AKSHI.

b. Për shpenzimet korrente dhe kapitale kontrata lidhet në emër të titullarit të AKSH-it, me përfitues të mallit dhe/ose shërbimit, AKSH-in, pasi fondet përkatëse për vitin 2023 për mirëmbajtjen e sistemeve të TI të njëjësive të qeverisjes qendrore si dhe fondet e investimeve për përmirësimin e sistemeve të TI, kushteve të AKSH-it dhe për Sistemet Qeveritare, janë të miratuara në buxhetin e AKSH-it. Këto kontrata depozitohen nga ana e AKSH-it në degën e thesarit për t’u regjistruar në SIFQ.

Për sa më sipër ky rekomandim në vijim do të ndiqet në auditimet që do të kryhen nga KLSH, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

Gjetje nga auditimi:

18. Rezultoi se 7 laboratorët e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve, në varësi të AKU, në të cilët duhet të kryhen analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve të ndryshëm në kafshë të gjalla janë jo eficient, pasi vetëm 2 laboratorë për periudhën në auditim kanë funksionuar pjesërisht ndërsa 5 laboratorët e tjerë janë jashtë funksionit si edhe numri i analizave të kryera për periudhën 2019-2020-2021 ka ardhur në rënie duke shkuar nga 138 për 2019 në 40 analiza për 2021.

Sa më sipër, si pasojë e mos akreditimit të laboratorëve në AKU, të mungesës së vazhdueshme të sigurimit të buxhetit për akreditim të këtyre laboratorëve; të mbivendosjes së kompetencave si në funksion ashtu edhe në burime njerëzore ndërmjet AKU-AKVMB-ISUV, aktiviteti i laboratorëve të AKU-së, me objekt shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, paraqitet me performancë negative, ndonëse krijimi i tyre është bërë për analizimin e mostrave për rastet e konstatuara ose të dyshimta, të shkaktuara nga kafsha e gjallë, me qëllim për të garantuar bio sigurinë ushqimore në ferma me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, së zhvillimit ose të përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë përpara se ato të kthehen në produkte ushqimore për njerëzit.

Rezultoi se numri i të punësuarve pranë laboratorëve të shërbimit veterinar në rang vendi është mjaft i ulët (vetëm 4 punonjës nga 9 që duhet të jenë), për shkak të, mos rekrutimit nga AKU të specialistëve veterinerë në laboratorë, të procesit të ristrukturimit në vite të institucionit të AKU-së, si dhe të mos realizimit nga AKU të trajnimeve të nevojshme edhe me stafin aktual të punësuar në laboratorët e shërbimit veterinar, veprime që kanë sjellë mos funksionimin e plotë të laboratorëve për shëndetin e kafshëve, dhe përdorimin nga buxheti i shtetit në zërin e shpenzimeve 600 & 601, në vlerën prej 4,956,000 lekë, pa efektivitet.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

22. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të transferojë Laboratorët e Mirëqenies dhe Shëndetit të Kafshëve nga AKU, pranë ISUV-it, si institucioni i akredituar në këtë fushë për të siguruar të plotë dhe të sigurt gjithë zinxhirin ushqimor, kjo edhe sipas motos të Komisionit Evropian , Kapitulli 12 “nga lindja/mbjellja deri në tryezë.”

Brenda vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me komentet e AKU, Grupi i Auditimit, kërkon zbatimin e rekomandimit dhe jo observacionin për gjetjen përkatëse pasi kjo fazë ka kaluar me përfundimin e RPA të performancës dhe Vendimin e Kryetarit të KLSH-së, dërguar në subjektet përkatëse.

Nga MBZHR nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

23. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të ngrejë një grup pune dhe të shqyrtojë vlerën 4,956,000 lekë, të përdorura pa efektivitet, pa eficiencë dhe pa ekonomikitet nga buxheti i shtetit në burimet njerëzore të AKU lidhur me laboratorët e mirëqenies dhe shëndetit të kafshëve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në lidhje me komentet e AKU, Grupi i Auditimit kërkon zbatimin e rekomandimit dhe jo observacionin për gjetjen përkatëse pasi kjo fazë ka kaluar me përfundimin e RPA të performancës dërguar në subjektet përkatëse.

Nga MBZHR nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

2.2 Sa efektive janë masat e marra për trajnimet dhe ngritjen profesionale të stafit përgjegjës ekzistues dhe të futur rishtazi në shërbimet veterinarë?

Gjetje nga auditimi:

19. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2021, Sektori i burimeve njerëzore në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve si dhe sektori i Zbatimit të Masave Profilaktike dhe IR në Drejtorinë e Veterinarisë nuk kanë miratuar një plan vjetor për trajnimin e veterinerëve, të punësuar rishtazi, numri i të cilëve aktualisht është 534.

-Nuk ka një regjistër të DR për numrin e veterinerëve të trajnuar dhe të atyre që nuk janë trajnuar, si dhe nuk ka një shpërndarje të barabartë të numrit të temave për trajnim.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

24. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të hartojnë çdo fillim viti një plan të detajuar trajnimesh me tema të mirë përcaktuara, si dhe duke i evidentuar ato në regjistër tip për të gjithë veterinerët e trajnuar me ditët e trajnimit.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023 e në vijim

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Sektori i burimeve njerëzore në AKVMB ka bërë në fillim të vitit një plan për trajnimin e punonjësve të AKVMB me tema të mirë përcaktuara sipas një modeli të veçantë dhe ka mbajtur një regjistër tip me ditët, personat dhe temat e trajnimit.

Nga verifikimi i regjistrit rezulton të jenë kryer trajnime të veterinerëve në rang drejtorish rajonale të vazhdueshme sipas temave të përcaktuara në fillim të vitit.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

3. A zbatohen në mënyrë efektive politikat e vendosura për sistemin (RUDA), sigurinë ushqimore dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve?

3.1. A është sistemi i informacionit efektiv në sigurimin e një kontrolli të mirë të shëndetit të kafshëve që nga lindja, lëvizja, therja ose vdekja, si dhe gjurmueshmëria e kafshëve dhe mbikëqyrja epidemiologjike?

Gjetje nga auditimi:

20. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka miratuar me akt normativ, bazën e të dhënave të sistemit RUDA si aktin e krijimit të bazës së të dhënave shtetërore; nuk ka miratuar rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore, të cilat duhet të përcaktohen nga institucioni administrativ dhe të miratohen nga titullari i tij.

21. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me kontrollin, aktivizimin dhe çaktivizimin e llogarive në sistemin RUDA, nuk ka menaxhuar llogaritë e përdoruesve të sistemit RUDA, për të siguruar që qasja është e kufizuar në mënyrë të përshtatshme dhe që përdoruesit të kenë vetëm privilegjet që u nevojiten.

22. Sistemi RUDA nuk jep informacion për datën e hapjes së llogarisë së përdoruesit, datën e mbylljes së llogarisë së përdoruesit dhe nuk mbështetet nga autorizimet e lëshuara dhe të regjistruara për këto veprime. Rezultuan fillimisht gjithsej 312 përdorues, dhe aktualisht janë 216 përdorues, për të cilët mungojnë datat e aktivizimit dhe çaktivizimit të llogarive të përdoruesve.

23. Sistemi RUDA në seksionin "certifikata individuale e lëvizjes", lejon regjistrimin e certifikatave të lëvizjes së kafshëve me numra seriale të njëjtë, ku për periudhën nën kontroll janë regjistruar 22,642 certifikata lëvizjeje në total, prej tyre të dublikuara janë 3,426 ose 15.1%, domethënë numri i serisë së certifikatave të lëvizjes së kafshëve nuk është unik, gjë që bie ndesh me udhëzimin për përdorimin e sistemit RUDA i cili thotë se “Vlerëson përputhshmërinë e të dhënave të certifikatës që po regjistrohet me të dhënat e certifikatës së regjistruar më parë. Në rast se aplikacioni konstaton se keni regjistruar një certifikatë me të njëjtin numër serie, atëherë certifikata nuk do të regjistrohet dhe do të merrni mesazhin me ngjyrë të kuqe”. Për rrjedhojë, rezulton se sistemi RUDA në këto raste nuk ka mekanizmat e duhur parandalues për të mos lejuar dublimin.

24. Sistemi RUDA, nuk ofron të dhëna në seksionet - "Eliminimet sanitare", - "Therje sanitare" e "Formularët e gjurmimit", pasi nuk ka akses në të dhënat e eksportit në program, gjithashtu eksporti i numrit total të certifikatave veterinarë të lëvizjes në sistem nuk realizohet, duke ndikuar kështu, në prodhimin e raporteve të paplotë nga sistemi RUDA në lidhje me gjurmimin e kafshëve dhe uljen e efektivitetit të masave profilaktike kundër sëmundjeve të kafshëve. Struktura dhe organizimi raportues i sistemit RUDA nuk përputhet me strukturën organizative të AKVMB-së; sistemi nuk prodhon raporte të bazuara në DRVMB; si dhe operatorët dhe stafi i AKVMB-së nuk janë mjaftueshëm të trajnuar për përdorimin si duhet të sistemit. Gjithashtu mungesa e popullimit të sistemit jo direkt nga veterinerët e shërbimit zyrtar ndër vite, por nga një operator në çdo rreth, mungesa e një sistemi unik statistikor dhe analiza periodike mujore e miratuar nga organet eprore nga qendra në bazë, në lidhje me raportet e monitorimit të saktësisë së popullimit të sistemit RUDA, kanë çuar në mbartjen e gabimeve dhe pasaktësive, duke ulur ndjeshëm eficiencën e shërbimeve veterinarë, efektivitetin dhe cilësinë e të dhënave të sistemit të informacionit RUDA.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

25. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të hartojë draft vendimin e aktit të krijimit të bazës së të dhënave shtetërore për RUDA-n dhe të hartojë një rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave të RUDA-s. Të analizojë problemet e konstatuara në lidhje me përdoruesit e sistemit RUDA, duke marrë masat e nevojshme për aktivizimin dhe ç'aktivizimin në kohë të llogarive dhe të mbajë gjurmët e auditimit të tyre, veçanërisht të përdoruesve. Gjithashtu të përcaktojë qartë lidhjen e attributeve të përdoruesve të sistemit me pozicionin e punës, të zhvillojë sistemin për popullimin e tij nga "veterinerët e shërbimit" e "veterinerët e kontrollit" në kohë reale dhe të prodhojë raporte statistikore sipas DRVMB-ve.

Brenda vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga MBZHR në lidhje me sa më sipër është bërë vlerësimi i sistemit RUDA duke parë nevojat për ndryshim dhe përmirësim të tyre në bashkëpunim me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit RUDA ATT dhe ekspertët të projektit të BE SAFIAL. Në fund të procesit të vlerësimit, ekspertët e sistemit do të asistojnë në hartimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave të RUDA-s. (Bashkëlidhur emaillet e bashkëpunimit dhe korrespondenca përkatëse.)

Nga verifikimi i korrespondencës të paraqitur nga specialistët e sistemit RUDA ka filluar bashkëpunimi për aktivizimin dhe çaktivizimin në kohë të llogarive dhe mbajtjes së gjurmëve të auditimit, veçanërisht të përdoruesve por është një proces ende në vijim dhe si rezultat nuk ka një produkt përfundimtar për përgatitjen e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave të RUDA-s.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

26. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të analizojë rastet e konstatuara të dublimit të numrave të serive të certifikatave të lëvizjeve të kafshëve dhe të marrin masat e nevojshme për parandalimin automatik nga sistemi.

Brenda vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga MBZHR në bashkëpunim me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit RUDA ATT, është realizuar vendosja e numrave të rinj serialë në certifikatat shëndetësore të lëvizjes së kafshëve në të gjithë vendin krahasuar me certifikatat shëndetësore të lëvizjes unike në nivel qarku. Përveç numrave serialë, certifikatave u janë shtuar edhe dy shkronja të alfabetit të cilat rrisin nivelin e sigurisë.

Nga sa më sipër nga MBZHR është arritur që Sistemi RUDA në mënyrë automatike nuk lejon dublimin e certifikatave shëndetësore të lëvizjes së kafshëve.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

27. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të shqyrtojë dhe t'i japë zgjidhje ankesave të përdoruesve të sistemit RUDA, për seksionet " Eliminimet sanitare", "Therja sanitare", "Formularët e gjurmimit" dhe për eksportin e numrit të përgjithshëm të certifikatave veterinarë të lëvizjes në këtë sistem.

Brenda vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: MBZHR ka shqyrtuar problematikat nga përdoruesit e sistemit RUDA dhe ia ka përcjellë kompanisë së mirëmbajtjes ATT e cila ka bërë zgjidhjen e tyre në kohë reale. Ky është një proces në vijimësi dhe nga bashkëpunimi me AKVMB është arritur minimizim i këtyre ankesave.

U konstatua se janë shqyrtuar në kohë ankesat dhe bashkëpunimi i Sektorit të Epidemiologjisë dhe I &R në MBZHR me AKVMB ka rezultuar efektiv.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

25. Në dy raportet e sistemit RUDA të gjendjes së kafshëve sipas “regjistrimit” dhe “matrikulimit”, vërehen dallime të dukshme shifrash mes tyre. Të dy raportet duhet të japin të njëjtin rezultat (duhet të jenë të barabartë) në të njëjtën datë për kategoritë e gjedhit dhe të imëtat. Për qarkun e Tiranës dhe qarkun e Vlorës, që janë marrë në konsideratë, në rubrikën “Matrikulimi”, “Konsultimi i kafshëve” krahasuar me “Inventarin sipas fermave”, “Regjistri i fermave” rezultatet janë të ndryshme me diferenca në përqindje nga 29-50 % më shumë matrikulime sesa numri i krerëve fizike, duke ndikuar në uljen e efektivitetit të sistemit RUDA.

26. Pothuajse gjysma e popullsisë së gjedhit, që përbën 195,899 krerëve, janë regjistruar jashtë periudhës 15-ditore të regjistrimit dhe identifikimit, gjë që bie ndesh me manualin e procedurave për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale . Janë vendosur sanksione ligjore të papërfillshme në numër ndaj fermerëve për shkelje të legjislacionit veterinar.

27. Pasaktësitë e të dhënave rrezikojnë të rrisin më tej kostot e burimet njerëzore dhe materiale për pastrimin e sistemit, si dhe do të ulin integritetin e masave profilaktike për luftën dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive, shpërblimet për eliminimin e kafshëve dhe monitorimin etj. Inventari i derrave nuk është identifikuar dhe regjistruar në sistemin RUDA, duke mos përmbushur objektivat e planifikuar për matrikulimin e derrave brenda vitit 2020 nga MBZHR-ja dhe duke ndikuar në këtë mënyrë në uljen e eficiencës dhe efektivitetit të sistemit RUDA.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

28. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të marrin masa për pastrimin e sistemit RUDA nga regjistrimet e kafshëve fiktive dhe ta monitorojnë atë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga inventarizimi i kryer dhe saktësimi i të dhënave në sistemin RUDA, duke krahasuar midis datës 31.05.2022, me datën 31.05.2023, rezultoi se Gjedhë ishin 311,618 krerë janë 281,750 krerë.

Të imta ishin 2,186,891, janë: 1,947,843 krerë.

Derra ishin 83,000 krerë, janë 80,803 krerë.

Një Thundrakët ishin 53,000 krerë janë 65,000 krerë.

Shpendë ishin 551,000 janë 552,000

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

29. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të marrin masa të vendosin në sistemin e vetë deklarimit emrin e pronarit ose kujdestarit të kafshëve dhe ta monitorojnë e kontrollojnë atë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Aktualisht në sistemin Ruda, tek rubrika regjistri i fermës, një ndër rubrikat e detyrueshme për plotësim kur regjistrohet një fermë e re është edhe mbajtësi i kafshës, që mund të jetë i ndryshëm me pronarin dhe deklarohet nga vetë pronari. Bashkëlidhur do të gjeni formatin e regjistrimit të fermës nga sistemi Ruda.

Pas verifikimit të formularit rezulton që është shtuar si modul në sistemin RUDA.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

30. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të kontrollojnë e marrin masat konkrete ndaj personave përgjegjës për objektivin e pa realizuar për specien e “derrit” nga mbajtësit e kafshëve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në zbatim të rekomandimit, ka filluar matrikulimi i derrave dhe deri tani janë matrikuluar 1,347 derra në sistemin Ruda dhe ky proces është në vazhdim dhe monitorim të mëtejshëm.

Nisur nga rezultati i mësipërm dhe verifikimi në sistemin RUDA, GA arriti në konkluzionin se matrikulimi i derrave është një proces që po kryhet sistematikisht nga AKVMB.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Gjetje nga auditimi:

28. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve për sëmundjet infektive të konfirmuara pozitiv si, “gjuha blu” ka raportuar 140 raste me 2 – 17 ditë vonesë; dhe për "artrit encefalit" 1 rast vonesë prej 11 ditësh , kur ky raportim duhet të kryhej brenda 24 orëve sipas OIE-së ; për sëmundje të tjera si të “brucelozës së gjedhit” të konfirmuara pozitiv janë raportuar 28 raste ku për 8 raste ka pasur raportim deri në 45 ditë vonesë. Gjithashtu 50% e sëmundjeve raportohen

me më shumë se 48 orë vonesë nga data e shfaqjes së sëmundjes. Për të gjitha sëmundjet përkatëse, nuk është vendosur një sistem paralajmërimi i hershëm.

29. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve nuk i ka dërguar për analizë të gjitha rastet e raportuara si shpërthime të sëmundjes për periudhën e audituar. Gjithashtu, për rezultatet e analizave laboratorike përgjigjet nga ISUV-i janë kthyer jashtë afateve të parashikuara ligjore, konkretisht:

- për sëmundjen e “plasjes” për 33 raste janë kthyer përgjigje jashtë afatit 5 ditor,
- për sëmundjen e “brucelozës”, për 21 raste janë kthyer përgjigje jashtë afatit 21 ditor,
- për “gjuha blu” për 95 raste janë kthyer jashtë afatit 10 ditor dhe
- 3 raste të gripit të shpendëve janë kthyer jashtë afatit 2 ditor.

Këto afate janë shpallur nga ISUV për kohën maksimale të kryerjes së analizave përkatëse, dhe me gjithë kohën maksimale në dispozicion përgjigjet janë kthyer në tejkalim të këtyre afateve të mirë përcaktuara në ligj.

30. Sistemi RUDA nuk jep automatikisht informacion në e-mail në kohë reale për aktorët kryesorë në zinxhirin komandues të shërbimeve veterinarë MBZHR-në, AKVMB-në, AKU-në dhe ISUV-in, menjëherë pas plotësimit të formularit të fillimit të një shpërthimi sëmundjeje, duke ulur efektivitetin e sistemit RUDA dhe duke mos përmbushur detyrat e tij funksionale.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

31. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të rishikojnë politikën e përcjelljes së informacionit për rastet e shpërthimeve të sëmundjeve "menjherë të lajmërueshme" dhe " të lajmërueshme", ku të përcaktohen mënyrat e raportimit dhe dokumentimit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Për rastet e sëmundjeve menjëherë të lajmërueshme si Plasja, pas lajmërimit të menjëhershëm për satet pozitive, Drejtoria e Përgjithshme harton urdhrin në bazë të programit të sëmundjes së Plasjes. Bashkëlidhur keni:

Shkresën 49/2 prot. datë 27.01.2023 urdhër “Për masat që zbatohen pas konfirmimit të plasjes në drejtorinë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve Vlorë”.

Shkresën 128 prot. datë 09.02.2023 urdhër “Për masat që zbatohen pas konfirmimit të plasjes në drejtorinë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve Vlorë”.

Për sëmundjen e Murtajës Afrikane të Derrave u hartua një plan veprimi nga Drejtoria e Përgjithshme për katër drejtoritë rajonale sipas shkresës nr. 444/5 prot. datë 27.07.2023 më lëndë: Dërgim i planit të veprimit të Murtajës Afrikane të Derrave’.

Për sëmundjen e Influcës Aviare u hartua një plan veprimi nga Drejtoria e Përgjithshme për katër drejtoritë rajonale sipas shkresës nr. 1474/1 prot. datë 04.11.2023 më lëndë: Dërgimin e planit të veprimit mbi sëmundjen e Influcës Aviare’

Për sa më sipër nga AKVMB janë marrë masat e duhura nëpërmjet shkresave të sipër cituara për politikën e përcjelljes së informacionit për rastet e shpërthimeve të sëmundjeve "menjherë të lajmërueshme" dhe " të lajmërueshme".

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Rekomandime:

32. Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për akreditimin e analizave laboratorike të sëmundjeve të kafshëve si dhe njoftimin e menjëhershëm të rezultateve të analizave në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në përgjigje ISUV ka sqaruar se nga viti në vit ISUV ka një rritje të testeve të akredituara dhe konkretisht në shifrat si vijon:

Për periudhën e audituar 01.01.2019 deri në 31.12.2021 numri i testeve në vite është;

Viti 2019 - 5 teste;

Viti 2020 - 5 teste;

Viti 2021 - 8 teste; (5 + 3);

Viti 2022- 12 teste (8 +4).

Numri. i testeve të planifikuara për tu akredituar në përfundim të vitit 2023 është mirë mbajta e 12 testeve dhe zgjerimi i 6 testeve të reja.

Sa i takon njoftimit të menjëhershëm sqarojmë se në historikun e praktikave institucionale ky njoftim është bërë nëpërmjet adresave zyrtare elektronike dhe shkresore.

Nga sa më sipër nga ISUV është ruajtur numri i testeve të kryera në vite por ende nuk ka rezultate konkrete për akreditimin e 12 testeve të reja dhe zgjerimit për 6 të tjera.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.

3.2 A është sistemi RUDA efektiv për planifikimin e matrikulimit, masat veterinare profilaktike, ç' rrënjosjen e sëmundjeve infektive, për kafshët, kontrollin veterinar gjatë eksportit e të importit?

Gjetje nga auditimi:

31. Në shumicën e tregjeve dhe në një pjesë të mirë të thertoreve, veterinerët e kontrollit nuk kanë akses të plotë në sistemin RUDA, gjithashtu lëvizja e kafshëve me certifikatë veterinare, identifikimi dhe regjistrimi i tyre është një objektiv i paarritur plotësisht nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe i Mbrojtjes së Bimëve. Certifikatat e lëvizjes që lëshohen, nuk plotësohen me të gjitha të dhënat, në lidhje me destinacionin e saktë të lëvizjes, detyrim ligjor i veterinerëve, duke riskuar sigurinë ushqimore pasi ndalohet lëvizja ose transportimi i kafshëve ose kafshëve të paidentifikuara, në të cilat nuk janë kryer masat e programit shtetëror të profilaksisë .

32. Tregtarët e kafshëve nuk njihen si njësi e veçantë blegtorale. Tregjet e kafshëve nuk kanë gropa për dezinfektimin e kafshëve apo mjetet e transportit në hyrje, për pasojë cenojnë sigurinë ushqimore të konsumatorit.

33. Gjatë periudhës 2019-2020, AKU nuk ka kryer asnjë analizë laboratorike për të identifikuar sëmundjet e kafshëve në PIK siç parashikohet në manualet që duhet të ndiqen në PIK, pasi kërkohet që frekuenca e marrjes së mostrave të jetë minimale prej 3% të ngarkesave. Gjithashtu, mostrat duhet të merren nga të paktën 10% e kafshëve të ngarkesës ose nga të paktën 4 kafshë. Inspektorët e AKU në PIK nuk kanë akses dhe atributë për të përdorur sistemin RUDA për të regjistruar kafshët sipas destinacioneve të tyre përkatëse për thertore ose ferma të remontit. Mungesa e marrjes së mostrave në PIK nga kafshët për testime më të thelluara, dhe mjaftueshmëria vetëm me inspektimet fizike të tyre, si dhe mungesa e qendrave të karantinës , tregon për një performancë jo efektive të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në zbatimin e politikave të inspektimit dhe kontrollit të kafshëve të gjalla gjatë importit në PIK, duke ndikuar në uljen e sigurisë ushqimore në vend.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

33. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të hartojnë një memorandum bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për të përgatitur inspektime të përbashkëta dhe të vazhdueshme në pikat kritike, si tregjet e kafshëve dhe rrugët për të ndaluar lëvizjen e kafshëve të pa certifikuar si dhe të bashkëpunojnë e Bashkitë për përgatitjen e një programi dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij për përmirësimin e kushteve higjienë-sanitare dhe dezinfektimin e kafshëve në hyrje të tregjeve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: AKVMB në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit ka lidhur një Marrëveshje Bashkëpunimi "Për luftën kundër aktiviteteve të paligjshme në fushën e veterinarisë", me qëllim përcaktimin e masave dhe të detyrave efikase për garantimin e rendit e të sigurisë në kryerjen e detyrave që iu ngarkon ligji Veterinerëve Zyrtarë, parandalimin e veprimeve të kundërligjshme të ngjarjeve kriminale që cenojnë mbarëvajtjen e inspektim -kontrolleve për lëvizjen e kafshëve drejt tregjeve të kafshëve të gjalla pa matrikuj, pa certifikatë lëvizje, qarkullimin e mjeteve të transportit pa autorizim për lëvizje të kafshëve të gjalla, rritjen e nivelit të bashkëpunimit të strukturave, për një luftë frontale të përbashkët ndaj kundërvajtësve në fushën e Veterinarisë. Planet e veprimit të detajuara nga ana e Drejtorisë rajonale për inspektime të përbashkëta në bashkëpunim me Policinë e Shtetit (shkresa nr. 56/1 prot. datë 01.02.2023 DRVMB Tiranë, shkresa nr.68/1 prot. datë 31.01.2023 DRVMB Vlorë, shkresa nr.76 prot. datë 30.01.2023 DRVMB Elbasan, shkresa nr.57/1 prot. datë 06.02.2023 DRVMB Shkodër). Nga verifikimi i shkresave rezultoi se është miratuar marrëveshja e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit Për luftën kundër aktiviteteve të paligjshme në fushën e veterinarisë", me nr. prot 1101/4, dt 21.01.2023.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Rekomandimi 34. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të marrin masa për hapjen e aksesit në sistemin RUDA për "veterinerët e shërbimit" dhe "veterinarët e kontrollit" që lëshojnë "certifikatat e lëvizjes" në sistemin RUDA, në të gjitha feramat, tregjet e thertoret e vendit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: AKVMB në bashkëpunim me MBZHR dhe kompaninë mirëmbajtëse të sistemit RUDA ka realizuar 100% hapjen e aksesit për të gjithë veterinerët që lëshojnë certifikatat e lëvizjes në tregjet e kafshëve të gjalla dhe thertoreve.

Gjithashtu për sa i përket veterinerëve që lëshojnë certifikatat e lëvizjes në fermë, në bashkëpunim me Projektin SAFIAL, po bëhet e mundur hapja e aksesit për veterinerët në sistemin RUDA dhe pajisja me tableta për të plotësuar këto certifikata në moment në fermë.(bashkëlidhur email-i për bashkëpunimin me projektin SAFIAL). Nga verifikimi i shkresave rezultoi është realizuar hapja e aksesit për "veterinerët e kontrollit" dhe po vazhdon puna për pajisjen me tableta për "veterinerët e shërbimit" .

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Rekomandimi 35. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të bashkëpunojë me Bashkitë për përgatitjen e një programi dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij për përmirësimin e kushteve higjienë-sanitare dhe dezinfektimin e kafshëve në hyrje të tregjeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: AKVMB nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ka kërkuar bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nëpërmjet

shkresave (nr. 1090 prot. 14.09.2022, nr. 372 prot. datë 09.05.2022, nr. 282 prot. datë 01.04.2022, nr. 242 prot. datë 20.03.2022, nr. 239 prot. datë 17.03.2022, nr. 147 prot. datë 15.02.2022, nr. 168, 168/1 prot. datë 15.03.2022, nr. 117 prot. datë 06.09.2022, nr. 570 prot. datë 17.05.2023, nr. 290 prot. 26.04.2023, nr. 79 prot. 27.01.2022), por nga ana e Bashkive nuk ka marrë asnjë reagim pozitiv.

Nga verifikimi i shkresave, AKVMB ka kërkuar vazhdimisht këtë bashkëpunim por nga Bashkitë nuk ka marrë asnjë reagim pozitiv duke lënë tregjet në të njëjtat kushte higjieno sanitare të cilat cenojnë sigurinë ushqimore.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces

Rekomandimi 36. Autoriteti Kombëtar Veterinar e Mbrojtjes së Bimëve të marrë masa që tregtarët e kafshëve të regjistruhen dhe kodohen si “njësi blegtorale” dhe të regjistruhen në sistemin RUDA. **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:** Nga verifikimi i dokumentacionit për këtë rekomandim të paraqitur nga AKVMB janë marrë masat dhe është bërë regjistrimi i tregtarëve në QKB duke u pajisur me niptin përkatës dhe regjistruar më pas në sistemin RUDA.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Rekomandimi 37. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të rishikojë politikat dhe procedurat e kontrollit të kafshëve në import në përputhje me Kodin e Tokës së Shëndetit të Kafshëve, të zhvillojë gjithashtu sistemin RUDA për t'i dhënë akses popullimit të sistemit për kafshët e importuara në pikat e kalimit kufitar.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se është duke u punuar për arritjen e integritetit të të dhënave ndërmjet sistemit I&R RUDA dhe sistemit AKU-NET, për shfaqjen automatike të regjistrimit të kafshëve të importuara në pikat kufitare.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

38. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar Veterinar për Mbrojtjen e Bimëve, të shtojë fondet për çrrënjosjen e "tuberkulozit të gjedhit" e "brucelozës së gjedhit", rritjen e numrit të testimeve, kryerjen në kohë të fushatës vaksinimit të "brucelozës së imëtave" dhe programeve të monitorimit të sëmundjeve për të cilat realizohet mbikëqyrje aktive.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Për sa më sipër rezultoi se nga AKVMB janë marrë masat në lidhje me rritjen e numrit të testimeve, kryerjen në kohë të vaksinimit të "brucelozës së imëtave" dhe programeve të monitorimit të sëmundjeve për të cilat realizohet mbikëqyrje aktive.

Sa i përket kryerjes në kohë të fushatave të vaksinimit, u realizua vaksinimi me urdhër nr 194 prot. datë 03.04.2023 “Për miratimin e programit të kontrollit të brucelozës në të imta”.

Urdhri nr. 176 prot. datë 28.03.2023 ‘Për miratimin e programit të kontrollit të sëmundjes së plasjes’.

Urdhri nr. 175 prot. datë 28.03.2023 “Për miratimin e programit të kontrollit të brucelozës në gjedh”.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

39. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të hartojë dhe miratojë strategjinë e re të zhvillimit të sektorit veterinar, pjesë e së cilës duhet të jenë objektivat e pa realizuara deri në fund të vitit 2020.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: Në bazë të rekomandimit të lënë nga KLSH-ja kjo strategji është miratuar me urdhrin e Ministrit Nr.366, datë 16.6.2023 “Për Miratimin e Strategjisë të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”, dhe është botuar në fletoren zyrtare. Strategjia e sektorit veterinar është e përfshirë në strategjinë e miratuar me urdhrin e Ministrit Nr.366, datë 16.6.2023 “Për Miratimin e Strategjisë të Sigurisë Ushqimore 2023-2027”.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe dhe i zbatuar

Gjetje nga auditimi:

36. Megjithëse baza e të dhënave RUDA mbështetet në regjistrimin e matrikujve individuale të gjedhit dhe të imëtave për identifikimin e kafshëve, statusi i vaksinimit të një kafshe nuk njihet dhe për pasojë statusi i vaksinimit të kafshëve individuale është i pamundur të gjurmohet në zbatimin efektiv të masave dhe programeve veterinarë për garantimin e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së konsumatorëve

37. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vaksinimin e sëmundjes "brucelozës" nuk i është përmbajtur objektivave strategjike të SMKMT 2014-2020 sipas të cilave në vitin 2020 duhet të vaksinohet 100% e numrit të krerëve dhe në fakt është vaksinuar vetëm 16% e numrit të tyre. Programet e vaksinimit, si dhe fondet e planifikuara dhe prokurimet përkatëse për zbatimin e tyre vonohen nga MBZHR, duke shkaktuar vonesa në fillimin e fushatës së vaksinimit, veçanërisht për “brucelozën” e të imëtave dhe duke riskuar në këtë mënyrë përhapjen e sëmundjeve zoonotike dhe transmetimin e tyre nga kafshët te njerëzit.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Rekomandime:

40. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, të marrin masat për zhvillimin e sistemit RUDA për të mundësuar njohjen e statusit individual të kafshëve që janë vaksinuar ose testuar në programet e monitorimit të sëmundjeve.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së: MBZHR ka marrë masat dhe ka bashkëpunuar me AKVMB dhe kompaninë e mirëmbajtjes ATT duke përmirësuar modulet për pasqyrimin e procesit të vaksinimit dhe gjurmimit në nivel individual të kafshëve. GA është shprehur për sa më sipër në rekomandimet 29-30-31.

Statusi i rekomandimit: Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

1. Subjektet e audituar AKVMB dhe MBZHR nuk kanë paraqitur observacione, dokumentacion apo argumente shtesë në lidhje me projekt raport auditimin e përgatitur nga grupi i auditimit. MBZHR si institucioni kryesor në përfaqësim edhe të institucioneve të varësisë objekt auditim nëpërmjet e-mailit të datës 26.09.2023 ka shprehur dakordësinë mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve lënë nga grupi i auditimit.

2. Në lidhje me projekt raportin e auditimit dërguar nga KLSH në AKU sipas shkresës me nr.655/14, datë 13.09.2023, AKU ka sjellë observacionin me shkresë 4020/1, datë 13.10.2023, ku

observon në lidhje me rekomandimin 1.1, fq 29, rekomandimin 1.1, fq 33, dhe rekomandimin 1.2 fq 33.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së. Në lidhje me pretendimet tuaja grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë pasi në lidhje me këto rekomandime ju i keni pranuar ato në fazën e dërgimit të PRA dhe RPA së auditimit si dhe janë diskutuar me shkrim dhe në intervistat me gojë qëndrimet e të dy palëve. Procesi i zbatimit të rekomandimeve është shumë i rëndësishëm dhe vlerëson çfarë subjekti i audituar ka bërë për zbatimin e tyre dhe nuk është në fazën e diskutimit nëse këto rekomandime pranohen ose jo.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të përcjella me shkresën nr. 99/13, datë 12.09.2022, konstatohet se pjesa më e madhe e tyre është në proces zbatimi ose e zbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.Gjetje nga auditimi: Kuadri aktual ligjor nuk ka vepruar në funksion të efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së procesit veterinar, e për pasojë laboratorët për mirëqenien e kafshëve pranë AKU nuk kryejnë analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve të ndryshëm në kafshë të gjalla. Këto analiza realizohen nga ISUV. Kjo situatë është shkaktuar, si rrjedhojë e mos planifikimit të buxhetit për nisjen e procesit të akreditimit të laboratorëve, mos sigurimit të infrastrukturës së rrjetit laboratorik me pajisje si dhe mosparashikimi i kompetencës ligjore për marrjen e kampioneve (mostrave) nga inspektorët e AKU-së.

1.1 Rekomandimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të hartojë dhe miratojë akte administrative ligjore, për kalimin pranë ISUV, të kapaciteteve të burimeve njerëzore të stafit të laboratorëve të shëndetit të kafshëve dhe të sigurimit të vazhdueshëm të burimeve financiare, me qëllim rritjen e efektivitetit të laboratorëve për shërbimin veterinar.

Brenda vitit 2024

2. Gjetje nga auditimi: Lëvizja e kafshëve të importit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) në destinacion fermë, është objekt i dy kontrolleve nga dy autoritete AKU dhe AKVMB, të cilët nuk janë të unifikuar mbi këtë proces, për shkak të boshllëkut dhe mbivendosjes ligjore të funksionimit të institucioneve.

3. Gjetje nga auditimi: Inspektorët e AKU-së, në pikat e inspektimit kufitar (PIK), nuk kanë akses në sistemin RUDA, pasi sistemin e popullojnë vetëm struktura e shërbimit veterinar rajonal (AKVMB), në momentin kur ata shkojnë në destinacionin e pretenduar ku do të shkojë kafsha e gjallë. Hedhja e të dhënave individuale të kafshëve në PIK, si dhe ngarkimi i dokumentacionit është mjaft i rëndësishëm, pasi identifikimi i hyrjes së çdo kafshe në kohë në territorin e Shqipërisë, duke pasqyruar historikun e sëmundjeve nëse kanë pasur, me mjekimet e ndryshme që mund të kenë marrë, jep besueshmëri në sistemet e kontrollit në paralajmërim, përballimin e sëmundjeve si dhe sjell siguri të lartë ushqimore për konsumatorët shqiptarë dhe më gjerë.

2.1 Rekomandimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të hartojë dhe miratojë akte administrative ligjore, të hartojë politika për menaxhimin e riskut, në lidhje mbi kontrollin e lëvizjes së kafshëve të gjalla në Pikat e Inspektimit Kufitar nga struktura e shërbimit rajonal/AKVMB, më qëllim kryerjen me efektivitet të të gjithë veprimtarisë së shërbimeve veterinarë rajonale, të cilat impaktojnë menaxhimin e sistemit të informacionit RUDA.

Brenda vitit 2024

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së bimëve nuk i ka dërguar për analizë të gjitha rastet e raportuara si shpërthime të sëmundjes për periudhën e audituar. Gjithashtu, për rezultatet e analizave laboratorike përgjigjet nga ISUV-i janë kthyer jashtë afateve të parashikuara ligjore, konkretisht:

- për sëmundjen e “plasjes” për 33 raste janë kthyer përgjigje jashtë afatit 5 ditor,
- për sëmundjen e “brucelozës”, për 21 raste janë kthyer përgjigje jashtë afatit 21 ditor,
- për “gjuha blu” për 95 raste janë kthyer jashtë afatit 10 ditor dhe
- 3 raste të gripit të shpendëve janë kthyer jashtë afatit 2 ditor.

Këto afate janë shpallur nga ISUV për kohën maksimale të kryerjes së analizave përkatëse, dhe megjithë kohën maksimale në dispozicion përgjigjet janë kthyer në tejkalim të këtyre afateve të mirë përcaktuara në ligj.

1.1 Rekomandimi:

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë të marrë masa për akreditimin e analizave laboratorike të sëmundjeve të kafshëve si dhe njoftimin e menjëhershëm të rezultateve të analizave në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2024

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Rezultoi se 7 laboratorët e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve, në varësi të AKU, në të cilët duhet të kryhen analiza për diagnostikimin e sëmundjeve dhe parazitëve të ndryshëm në kafshë të gjalla janë jo eficient, pasi vetëm 2 laboratorë për periudhën në auditim kanë funksionuar pjesërisht ndërsa 5 laboratorët e tjerë janë jashtë funksionit si edhe numri i analizave të kryera për periudhën 2019-2020-2021 ka ardhur në rënie duke shkuar nga 138 për 2019 në 40 analiza për 2021.

Sa më sipër, si pasojë e mos akreditimit të laboratorëve në AKU, të mungesës së vazhdueshme të sigurimit të buxhetit për akreditim të këtyre laboratorëve; të mbivendosjes së kompetencave si në funksion ashtu edhe në burime njerëzore ndërmjet AKU-AKVMB-ISUV, aktiviteti i laboratorëve të AKU-së, me objekt shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, paraqitet me performancë negative, ndonëse krijimi i tyre është bërë për analizimin e mostrave për rastet e konstatuara ose të dyshimta, të shkaktuara nga kafsha e gjallë, me qëllim për të garantuar bio sigurinë ushqimore në ferma me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, së zhvillimit ose të përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë përpara se ato të kthehen në produkte ushqimore për njerëzit.

Rezultoi se numri i të punësuarve pranë laboratorëve të shërbimit veterinar në rang vendi është mjaft i ulët (vetëm 4 punonjës nga 9 që duhet të jenë), për shkak të, mos rekrutimit nga AKU të specialistëve veterinerë në laboratorë, të procesit të ristrukturimit në vite të institucionit të AKU-së, si dhe të mos realizimit nga AKU të trajnimeve të nevojshme edhe me stafin aktual të punësuar në laboratorët e shërbimit veterinar, veprime që kanë sjellë mos funksionimin e plotë të laboratorëve për shëndetin e kafshëve, dhe përdorimin nga buxheti i shtetit në zërin e shpenzimeve 600 & 601, në vlerën prej 4,956,000 lekë, pa efektivitet.

1.1.Rekomandimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të transferojë Laboratorët e Mirëqenies dhe Shëndetit të Kafshëve nga AKU, pranë ISUV-it, si institucioni i akredituar në këtë fushë për të siguruar të plotë dhe të sigurt gjithë zinxhirin ushqimor, kjo edhe sipas motos të Komisionit Evropian , Kapitulli 12 “nga lindja/mbjellja deri në tryezë.”

Brenda vitit 2024

2.1.Rekomandimi:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të ngrejë një grup pune dhe të shqyrtojë vlerën 4,956,000 lekë, të përdorura pa efektivitet, pa eficiencë dhe pa ekonomikitet nga buxheti i shtetit në burimet njerëzore të AKU lidhur me laboratorët e mirëqenies dhe shëndetit të kafshëve.

Brenda vitit 2024

V. Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin *në proces zbatimi*, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë të tyre, kërkohet përmbushja e plotë e tyre brenda vitit 2024.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSI 1

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

PËR AUDITIMIN ME TEMË: “EFEKTIVITETI I MENAXHIMIT TË SISTEMIT TË IDENTIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KAFSHËVE - RUDA”

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve te pranuar											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Masa për përmirësim ligjor	5	-	5	-	-	-	100%	-	1	-	-	-	2	-	-	-	2	-	-	-
2	Masa organizative	31	-	31	-	-	-	100%	-	23	-	1	-	7	-	-	-	0	-	-	-
3	Masa për eliminimin e efekteve negative	4	-	4	-	-	-	100%	-	2	289,701	-	-	-	-	-	-	2	4,956	-	-
TOTALI		40	-	40	-	-	-	100 %	-	26	289,701	1	-	9	-	-	-	4	4,956	-	-